



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 106-Prill 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga punimet në fushën e futbollit në Malishevë



Përmbajtja:

Kryetari Kilaj, priti në takim lamtumirës dhe njëkohësisht njohës kapitenin Kuoni respektivisht atë Rizzo nga LMT	3
Shtyhet përsëri mbledhja e XXV e Asamblesë Komunale	4
Një grup mërgimtarësh nga Gjermania, do të ndërtojnë shtëpi për familjen Xhyliqi	4
Me orë letrare përkujtohen dëshmorët Jahir Mazreku, Maliq dhe Hysen Sopaj	5
Kryetari Kilaj, kërkon nga Drejtoria i Inspektoratit të veprojnë konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi	5
Premtohet për mundësitë e ndërtimit të një ujësjellësi.....	6
Kryetari Kilaj siguron vazhdimin e përkrahjes për Shoqatën e të Verbërve	7
Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e njëzet të radhës	8
U konstituuan dy komitete	8
Komuna dhe “TIMI invest” nënshkruajnë marrëveshje për mbështetje të fermerëve	9
Filloi ndërtimi i shtëpisë për familjen e Sylejman Xhyliqit	10
KK mori vendimin për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal	11
Komiteti për Politikë dhe Financa dha tri rekomandime për Kuvend	12
Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve	12
Asambleja Komunale miratoi Planin e Reagimit për Malishevë	13

Kryetari Kilaj, priti në takim lamtumirës dhe njëkohësisht njohës kapitenin Kuoni respektivisht atë Rizzo nga LMT

Malishevë, 2 prill



Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim lamtumirës, respektivisht njohës, kapitenin M. Kuoni dhe A. Rizzo, udhëheqës në shkuarje i Njesisë së KFOR-it, LMT, që vepron në komunën e Malishevës, dhe atë në pritje të marrjes së detyrës.

Kapiteni Kuoni, ka falënderuar kryetarin e komunës për bashkëpunimin e treguar gjatë mandatit sa ai ka qenë në këtë mision, duke u shprehur se nga këtu “shkoj me mijëra përshtypje pozitive”. Njëkohësisht, ka prezantuar pasardhësin e tij, A. Rizzo, duke

bërë të ditur se ai në Njësinë e LMT-së në Malishevë, ka vepruar për gjashtë muaj të tërë, në detyrën e zëvendësit të tij.

Më pas kryetari Kilaj, duke e falënderuar kapitenin në largim për punën e bërë, ka vlerësuar misionin e LMT-së, që ushtron veprimtarinë në Malishevë. “Unë ju falënderoj për vlerësimin tuaj, por edhe për sjelljen tuaj këtu në Malishevë; njëkohësisht ju uroj suksese të mëtejme në vendin tuaj prej nga vini, Zvicër”, kështu tha midis tjerash z. Kilaj, në këtë takim, duke e përgëzuar për marrjen e detyrës edhe z. Rizzo si dhe duke u shprehur për një bashkëpunim të mëtejme.

Augusto Rizzo, i cili pritet të marrë komandën e LMT-së në Malishevë, në vendin prej nga vjen (Zvicra), ka përfunduar pesë misione në kontekstin ushtarak, ndërkohë që jashtë shtetit të tij, ky është misioni i parë që do të marrë në cilësinë e komandës.



Shtyhet përsëri mbledhja e XXV e Asamblesë Komunale

Malishevë, 2 prill

Në mungesë kuorumi, është shtyrë përsëri mbledhja e njëzetepeshtë (XXV) e Asamblesë Komunale të Malishevë, pasi këshilltarët komunal nga radhët e opozitës (LDK, AAK dhe LDD) braktisën seancën.

Seanca e sotme e Asamblesë Komunale, duhej të vazhdonte punimet, pasi ajo ishte ndërprerë javën e kaluar, për shkak të lëshimit të seancës nga ana e grupit të këshilltarëve të LDK-së, pasi nuk është miratuar kërkesa e tyre për shtyrjen e pikës katër të rendit të ditës, që kishte të bënte me shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës nr. 01/373 datë, 16.03.2012 për harmonizimin e planit zhvillimor urban, Malisheva 2004 - 2014 me Ligjin për planifikimin Hapësinor të Republikës së Kosovës, me arsyetimin e mungesës së materialit.



Për të njëjtën arsye, këshilltarët komunal nga radhët e tri partive opozitare, lëshuan përsëri mbledhjen, duke shkaktuar mungesë kuorumi.

Një grup mërgimtarësh nga Gjermania, do të ndërtojnë shtëpi për familjen Xhyliqi

Malishevë, 3 prill

Një grup bashkatdhetarësh, që jetojnë dhe punojnë në Gjermani, kanë marrë iniciativë, që të ndërtojnë shtëpi për familjen e S. Xhyliqit nga fshati Marali, ndërsa iniciativën e mërgimtarëve tanë, do ta përkrah edhe Komuna e Malishevës.

Lidhur me këtë çështje, sot, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur z.Isuf Gashi, përfaqësues i kryesisë së klubit të futbollit “Drita” në Gjermani, të cilët edhe kanë marrë iniciativën për ndërtimin shtëpisë për familjen Xhyliqi.



“Unë ju falënderoj për gatishmërinë tuaj, për ta ndihmuar këtë familje. Ne në vazhdimësi kemi ndihmuar, por është e pamundur që t’ju dalim në ndihmë të gjitha familjeve në nevojë, ndërkohë që ndihma juaj është për tu vlerësuar”, tha kryetari Kilaj, duke e falënderuar z. Gashi për këtë iniciativë, ndërsa i siguroj që edhe komuna do të kontribuoj edhe në këtë rast.

Në anën tjetër, Isuf Gashi, ka sqaruar se një pjesë e mjeteve është siguruar, ndërsa edhe një pjesë tjetër, pritet të sigurohet nga një koncert humanitar, që do të mbahet këto ditë në Gjermani.

Me orë letrare përkujtohen dëshmorët Jahir Mazreku, Maliq dhe Hysen Sopaj

Malishevë, 3 prill

Me anë të një ore letrare, të organizuar nga Shoqata për kulturë dhe letërsi “ Tafil Kelmendi “ në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë përkujtuar dëshmorët e kombit, Jahir Mazreku, Maliq Sopaj dhe Hysen Sopaj, në 13 vjetorin e rënies.



Në këtë orë letrare, përveç zyrtarëve komunal, morën edhe qytetar të shumtë, bashkëluftëtar të dëshmorëve dhe familjarë.

Poezi kushtuar dëshmorëve të kombit dhe luftës së drejt për liri, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lexuan poet nga klube dhe shoqata të ndryshme të shkrimtarëve, nga të gjitha trojet shqiptare.

Kryetari Kilaj, kërkon nga Drejtoria i Inspektoratit të veprojnë konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi



Malishevë, 4 prill

Në një takim me drejtorin e Drejtorisë për Inspektorat dhe inspektorët e kësaj drejtorie, kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka kërkuar në mënyrë rigoroze që të veprohet konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

“Kërkoj nga ju që të hulumtoni rastet dhe të merrni masat e duhura, ndaj çështjeve të caktuara, konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi”. Në këtë kontekst, sipas kryetarit Kilaj, duhet të inspektohen dhe të merren masa, ndaj ndërtimeve pa leje, ndaj hedhjeve të mbeturinave pa vend, etj.

Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, z. Ismet Kafexholli, u zotua se së bashku me stafin e tij, do të veproj në teren, dhe do të marrë masat e duhura në raste të shkeljes së ligjit, apo rregulloreve komunale që kanë të bëjnë me ndërtime pa leje, por edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me punën e tyre

Gjatë një takimi me kryetarin e KKK dhe përfaqësues të shoqatës humanitare “Jesus Christ”

Premtohet për mundësitë e ndërtimit të një ujësjellësi

Malishevës, 5 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj ka pritur në takim, udhëheqës të Kryqit të Kuq të Republikës së Kosovës, konkretisht kryetarin z. Xhevat Shkodra me bashkëpunëtor, dhe përfaqësuesit e shoqatës humanitare “Jesus Christ”, z. Sam dhe Andrea Juncker, me ç’rast është diskutuar për mundësitë e ndërtimit të një ujësjellësi për ndonjërin nga fshatrat e Komunës së Malishevës, i cili posedon resurse në këtë lëmi.

Z. Kilaj ka falënderuar të pranishmit për këtë interesim mjaftë jetik për banorët e

kësaj komune duke u shprehur se “Malisheva, edhe pas kaq vjetësh që ka dalë nga lufta, ende ka nevojë për investime jetike, sidomos për ujësjellës, kanalizime e të ngjashme”. Ndërkohë nuk ka hezitur të shprehë gatishmërinë e pjesëmarrjes në realizimin e një projekti për ujësjellës sikur planifikon shoqata e lartpërmendur.



Sipas z. Sam, “kjo shoqatë ushtron veprimtarinë në disa segmente jetësore, si në shëndetësi, çështje sociale, e së fundmi edhe në ndërtim ujësjellësish”. Në kontekstin e ndërtimit të ujësjellësit, është përzgjedhur komuna e Malishevës, për një investim të mundshëm.

Në parim janë dakorduar që fshati në të cilin do të investohet në këtë aspekt, është Drenoci, i cili do të lidhet me ujësjellësin e Gurbardhit, dhe për të cilin ekziston edhe projekti. Ky fshat është më i madhi në komunën e Malishevës, më rreth katër mijë banorë. Me këtë rast u premtua se shoqata “Jesus Christ”, do të bëjë furnizimin me material, ndërsa punimet do ti kryej Komuna e Malishevës.

Kryetari Kilaj siguron vazhdimin e përkrahjes për Shoqatën e të Verbërve

Malishevë, 6 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të shoqatës së të verbërve në Republikën e Kosovës, z. Mexhid Funiqi, me ç’rast janë diskutuar një varg çështjesh që ndërlidhen me këtë aspekt.

Fillimisht z. Funiqi, ka falënderuar kryetarin e Komunës së Malishevës, z. Kilaj, për mbështetjen që i jep shoqatës së të verbërve në Malishevës, duke kërkuar që kjo mbështetje të vazhdojë edhe më tutje derisa të bëhet një zgjidhje definitive për këtë shtresë të shoqërisë. “Unë jam i informuar dhe u jam mirënjohës



që si kryetar komune, i keni mbështetur në vazhdimësi, që nga viti 2001, shoqatën e të verbërve në Malishevë, mirëpo do të kërkoja nga ju që këtë mbështetje financiare ta bëni edhe më tutje, derisa të bëhet një zgjidhje definitive, ngase jemi në pritje që Ligji për të verbrit së shpejti të kalojë në Kuvendin e Kosovës”, kështu tha midis tjerash Mexhid Funiqi, drejtor ekzekutiv i shoqatës së të verbërve të Kosovës.

Në anën tjetër, kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, është shprehur të jetë i kënaqur me procedimin e ligjit për të verbrit, ndërsa ka siguruar se mbështetja e tij institucionale, nuk do të mungoj. “Unë jam i vetëdijshëm për gjendjen e kësaj shtrese të shoqërisë dhe më gëzon fakti që së shpejti do të hyjë në fuqi edhe ligji për të verbrit, dhe njëkohësisht ju siguroj se shoqata e të verbërve në Malishevës do të ketë përkrahjen dhe mbështetjen time institucionale edhe më tutje”.



I pranishëm në këtë takim ishte edhe kryetari i shoqatës së të verbërve në Malishevë, z. Isak Krasniqi, i cili gjithashtu shprehi falënderimin e tij ndaj komunës si mbështetëse e vazhdueshme e kësaj shoqate. Sipas z. Krasniqi në Komunën e Malishevës, ekzistojnë 186 persona të verbër, përfshirë këtu moshën nga 7-45 vjeç.

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e njëzet të radhës

Malishevës, 6 prill

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i kryesuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z. Ragip Begaj, ka mbajtur sot, mbledhjen e njëzetë të radhës, ku është shqyrtuar dhe është rekomanduar për Kuvend, një kërkesë e Kryetarit të Komunës, si dhe janë shqyrtuar disa kërkesa të qytetarëve.



KPF, pas shqyrtimit, ka rekomanduar për Asamblenë Komunale, kërkesën e Kryetarit të Komunës, z. Isni Kilaj, nr. 01/422 datë 04.04. 2012, për marrjen e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Muzeut të Komunës së Malishevës.

Po ashtu në këtë mbledhje janë shqyrtuar edhe kërkesat e ndryshme të qytetarëve një pjesë e së cilave kanë marrë përgjigje pozitive.

U konstituuan dy komitete

Malishevë, 13 prill



Sot janë konstituar dy komitete të formuara nga Asambleja Komunale e Malishevës, Komiteti për Shëndetësi dhe çështje sociale dhe Komiteti për Diasporë, si dhe janë zgjedhur kryesuesit e tyre, ndërsa në mungesë kuorumi, nuk është konstituar komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteran të UÇK-së.

Të dy mbledhjet e para të këtyre komiteteve, janë udhëhequr nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Ragip Begaj.

Kryesues i Komitetit për Shëndetësi dhe çështje sociale, është zgjedhur Besnik Hoti (LDK), ndërsa i atij për Diasporë, është zgjedhur Sevdie Kryeziu (PDK).

Komuna dhe “TIMI invest” nënshkruajnë marrëveshje për mbështetje të fermerëve

Malishevë, 13 prill

Komuna e Malishevës dhe institucioni mikrofinanciar “TIMI invest”, kanë nënshkruar marrëveshje, për dhënien e kredisë për bujqit, pa kamatë(interese). Memorandumi i bashkëpunimit, u nënshkrua mes Kryetarit të Malishevës, z.Isni Kilaj dhe z.Nexhmedin Kahirmani, drejtor i bordit të “TIMI invest”.

Përmes këtij memorandumi të nënshkruar sot, pritet që së paku 20 fermer nga Komuna e Malishevës, të marrin nga pesë krerë lopë, me një kredi pa kamatë, me afat prej dy vjetësh.



Sipas nenit 1, të këtij memorandumi, “të dy palët u dakorduan se do të bashkëpunojnë në sferën e kredi-dhënies, ku institucioni mikrofinanciar “TIMI invest”, do të jep kredi bujqësore dhe kredi për biznese të vogla, për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në Komunën e Malishevës, pa kamatë”.

Po ashtu, sipas kësaj kontrate, “asnjë kredi nuk do t’u jepet bujqve apo bizneseve të vogla të Komunës së Malishevës, pa pëlqimin e Drejtorisë për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari të Komunës së Malishevës”.

Filloi ndërtimi i shtëpisë për familjen e Sylejman Xhyliqit

Malishevë, 17 prill



Falë kontributit të mërgimtarëve tanë në Gjermani, Komunës së Malishevës dhe kompanive ndërtimore nga Malisheva, sot është vënë gurëthemeli i fillimit të ndërtimit të shtëpisë për familjen e Sylejman Xhyliqit nga fshati Marali.

Në ceremoninë e fillimit të ndërtimit të shtëpisë për familjen Xhyliqi, morën pjesë, një grup bashkatdhetarësh, të udhëhequr nga z.Enver Muzliukaj, të cilët edhe kishin marrë iniciativën për ndërtimin e shtëpisë për këtë familje, pastaj Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, këshilltari

komunal z.Feim Hoxha dhe banorë të fshatit Marali.

“Malisheva është një nga regionet më të varfra të Kosovës. Ne realisht, që disa vite po iu ndihmojmë familjeve që janë të pastrehë, por jemi në pamundësi t’i mbulojmë të gjitha kërkesat që ka komuna e Malishevës. Vetëm dy vitet e fundit, i kemi ndihmuar 60 familje për ndërtim të shtëpive, por ajo nuk mjafton, ashtu sikur nuk mjafton edhe kjo që sot po bëjmë, pasi ka shumë nevojë, sepse kemi një territor të gjerë, me 45 fshatra, me 70 mijë banorë. Megjithatë, kjo që ju sot po bëni është një ndihmesë e madhe, jo vetëm për këtë familje, por edhe për neve si komunë, pasi tash kemi një brengë më pak dhe kjo falë solidaritetit tuaj. Unë ju falënderoj nga zemra. Ky hap i juaj tregon edhe njëherë rrugën tuaj, që keni ndihmuar në vazhdimësi, duke përfshi kontributin tuaj edhe në luftën për çlirimin e vendit”, tha mes tjerash, kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj. Me këtë rast kryetari Kilaj, ka falënderuar edhe kompaninë “Lirimi” nga Mirusha, e cila do të kryej punimet e ndërtimit të kësaj shtëpie në baza vullnetare.

Ndërsa z.Enver Muzliukaj, duke folur në emër të bashkatdhetarëve që jetojnë në rrethinën e Shtutgardit, e që kanë ndihmuar në grumbullimin e mjeteve për ndërtimin e shtëpisë, për familjen Xhyliqi, tha se “ideja ka lindur, duke e ditur situatën ekonomike në Kosovë. Kemi marrë iniciativën për ndërtimin e



kësaj shtëpie, me moton “ndjehu krenar”, ku qytetarët tanë që jetojnë atje, kanë ndihmuar me grumbullimin e mjeteve për ndërtimin e shtëpisë për zotëri Sulejmanin. E arsyeja se pse kemi vendosur që të ndihmojmë pikërisht këtë familje në Malishevë është se, në rrethinën ku jetojmë ne, kemi më së paku qytetar nga Malisheva dhe me këtë rast, kemi dashur të tregojmë se, atje jemi Kosovë, nuk dimë regjione, nuk dimë fshatra, nuk dimë qytete, por për ne të gjithë janë njëjtë. Ne ju falënderojmë edhe juve si komunë për kontributin e juaj dhe të kompanisë “Lirimi”, me pronar Hashim Thaçi, nga Mirusha”.

Në emër të fshatit Marali, ka falënderuar kryetari i fshatit z.Rifat Hoxha, ndërsa fituesi i kësaj ndihme, z.Sylejman Xhyliqi, me lot në sy, i ka falënderuar të gjithë bashkatdhetarët dhe komunën e Malishevës, për ndihmën e dhënë për familjen e tij, ndihmë përmes së cilës, kjo familje, do të bëhet me strehë.

KK mori vendimin për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Malishevë, 19 prill

Asambleja Komunale e Malishevës, sot ka mbajtur seancën e njëzetepeshtë të radhës (e cila ishte shtyrë dy herë në mungesë kuorumi), ku janë marrë tri vendime, të cilat kanë të bëjnë me planifikimin zhvillimor komunal. Po ashtu në mbledhjen e sotme, ka dhënë betimin edhe këshilltari i ri nga radhët e LDK-së, Labinot Gashi.

Në fillim të seancës së sotme, këshilltari i ri komunal Labinot Gashi (LDK), ka dhënë betimin, duke e zëvendësuar bashkëpartiakun e tij, Bekim Samadraxha, pasi këtij të fundit, i është marrë mandati i këshilltarit komunal, për shkak të mungesave pa arsye në seancat e Asamblesë Komunale. Pas dhënies së betimit, të gjithë anëtarët e grupit të LDK-së, kanë lëshuar mbledhjen, deri në fund të saj, kur edhe janë kthyer te pika e fundit që ka të bëjë me të ndryshme.

Pas kësaj, kuvendi, ka shqyrtuar tri kërkesa të Kryetarit. Kërkesa e parë, kishte të bënte me Formimin e Këshillit të Ekspertëve të Planifikimit, ku pas miratimit të kësaj kërkesë, u mor vendim që ky këshill të jetë i përbërë nga nëntë anëtar.





Po ashtu, në mbledhjen e sotme, pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të Komunës për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, kuvendi mori vendim për hartimin e këtij plani, por edhe vendimin për harmonizimin e planit zhvillimor komunal urban, Malisheva 2004-2014, me ligjin për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës.

Komiteti për Politikë dhe Financa dha tri rekomandime për Kuvend

Malishevë, 20 prill

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), në mbledhjet e njëzetën të radhës, të mbajtur sot, ka shqyrtuar dhe kanë dhënë tri rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale.

KPF, pas shqyrtimit, ka rekomanduar për në Asamble, projekt propozimin e Planit për Reagim, i hartuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ndërsa sqarimet për këtë projekt, para anëtarëve të KPF-së, i ka dhënë drejtori i kësaj drejtorie, z.Halit Zogaj.

Po ashtu për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, është rekomanduar për debat edhe raporti financiar i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për “të hyrat dhe shpenzimet, për periudhën janar-mars 2012”.

Për në Asamblenë Komunale, është rekomanduar edhe kërkesa e Kryetarit të Komunës, për marrjen e vendimit për iniciimin e procedurave për dhënien me koncesion të pronës publike, përmes partneritetit publiko-privat.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 23 prill

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, si çdo të hënë, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, ku janë trajtuar çështje të ndryshme të punës së qeverisë komunale, me theks të veçantë, për ruajtjen e ambientit dhe pronës publike.



Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse, zbatim rigoroz të ligjit në mënyrë që të ruhet prona publike nga uzurpimet. Po ashtu në këtë mbledhje u kërkuar, që në asnjë mënyrë të mos lejohen ndërtime pa leje.

Në mbledhjen e sotme, kryetari Kilaj, edhe njëherë, i ka falënderuar publikisht mërgimtarët tanë dhe kompaninë “Lirimi”, për ndërtimin e shtëpisë për një familje në fshatin Marali, e cila ka filluar javën që shkoj.

Asambleja Komunale miratoi Planin e Reagimit për Malishevë

Malishevë, 30 prill



Asambleja Komunale e Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e njëzetegjastë të radhës, ku është miratuar Planin e Reagimit për Komunën e Malishevës, projektplan i propozuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Para këshilltarëve komunal, Planin e Reagimit e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, i cili edhe është përgjegjës në pyetjet e këshilltarëve, por i ka falënderuar edhe për sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna. Me këtë rast, komuna e Malishevës, për herë të parë

bëhet me Plan për Reagim, në raste krizave apo fatkeqësive të ndryshme.

Në mbledhjen e sotme, është miratuar edhe kërkesa e Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, për caktimin e lokacionit, në ngastrën kadastrale nr.P-72310047-00894-3, në sipërfaqe prej 0.15.94/ha, për ndërtimin e Muzeut të Komunës.

Po ashtu në këtë mbledhje, është shqyrtuar edhe raporti i të hyrave dhe shpenzimeve, për tremujorin e parë të vitit 2012. Sipas drejtorit për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, “deri më tani është alokuar 41.94% e totalit të buxhetit për komunën e Malishevës, ku prej këtyre, janë shpenzuar 44%”. Ndërsa për të hyrat vetanake, drejtori Krasniqi, tha se për tre muajt e parë, janë realizuar 13% e planifikimit të të hyrave vetanake”. Më pas z. Krasniqi, është përgjegjës në pyetjet e këshilltarëve për sqarimet shpesh të shpenzimit të buxhetit, ndërsa duke folur për të hyrat vetanake, ai tha se “pragu i realizimit të të hyrave,



që caktohet nga Ministria e Financave, nuk është real me numrin e banorëve dhe bizneseve, dhe për këtë arsye, nuk arrijmë të realizojmë atë prag të caktuar”.